



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 10.09.2018

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH QË PËRDMËSON MARRËVESHJEN, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL), PËR BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.28/2014””

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”*”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Alket Hyseni.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministri i Brendshëm z.Besfort Lamallari dhe z. Shkëlzen Rexhepi, përfaqësues i Zyrës së EUROPOL.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji që po paraqitet për miratim, ka si qëllim miratimin e amendimit të aneksit I të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, e cila është ratifikuar me ligjin nr.28/2014. Këto amendime janë propozuar në kuadër të ndryshimeve statutoire të Europol-it.

Marrëveshja e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 28/2014 ka patur si qëllim vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mbështesë shtetet anëtare të Bashkimit European dhe Republikën e Shqipërisë në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar në fushat e krimit, në veçanti përmes shkëmbimit të informacionit ndërmjet Europolit dhe Republikës së Shqipërisë.

Bashkëpunimi mes Republikës së Shqipërisë dhe Europolit materializohet nëpërmjet fushave përkatëse, të parashikuara nga neni 4 i kësaj marrëveshje, dhe konkretisht: i) shkëmbimi i informacionit; ii) shëmbimin e njohurive të specialistëve; iii) raportet e përgjithshme të situatave; iv) rezultatet e analizës strategjike; v) dhënia e informacionit në lidhje me procedurat e hetimit penal; vi) dhënia e informacionit mbi metodat e parandalimit të krimit; vii) pjesëmarrja në aktivitete trainimi; viii) dhënia e konsulencës dhe mbështetjes për hetimet penale individuale.

Në datën 1 maj 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europol-it dhe, si rrjedhojë, ka ndryshuar dhe kuadri i ligjor i saj. Mandati i ri i Europol-it mbulon vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, terrorizmin dhe format e tjera të krimit, që prekin dy ose më shumë vende të Bashkimit Evropian, ashtu siç është listuar edhe në aneksin I të rregullores së re të Europol-it.

Për rrjedhojë lind e nevojshme që është fusha e zbatimit të kësaj marrëveshje të përditësohet me të gjitha veprat penale, që janë renditur në Shtojcën të Rregullores së Europolit.

Marrëveshja bazë e ratifikuar nëpërmjet ligjit nr. 28/2014, ka parashikuar që anekset e kësaj marrëveshjeje dhe dispozitat e nenit 3 (3) mund të ndryshohen përmes shkëmbimit të notave ndërmjet palëve. Duke u mbështetur në këtë parashikim të marrëveshjes, drejtori i Europol-it ka kërkuar nëpërmjet një “format note”, përditësimin e përmbajtjes së aneksit I të marrëveshjes. Nga ana e palës shqiptare, është konfirmuar përditësimin e Aneksit I “Fushat e krimit” të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional e cila, po paraqitet për ratifikim në Kuvendin e Shqipërisë, është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 363, datë 20.06.2018.

Anëtarët e Komisionit vlerësuan se ky projektligj do të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit në luftën kundër formave të rënda të krimit ndërkombëtar dhe veçanërisht në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, në kuadër të angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ALKET HYSENI

ULSI MANJA